

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8303
E martë, 20 maj 2026
Çmimi 0.50 €

Me kërkesë të Albulena Haxhiut, KPK-ja shpall konkurs për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit



FAQE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PARAFUSHATË ME AKUZA E PËRPLASJE FIZIKE

FAQE 4-5




Më pak se dy javë para nisjes së fushatës zyrtare për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë,

skena politike është përfshirë nga akuza të ndërsjella për shantazh, presione dhe keqpërdorim të burimeve

shtetërore. Partitë kryesore shqiptare e fajësojnë njëra-tjetrën për krizën institucionale që ka çuar në zgjedhje të reja

KOSOVA KA ALEATË PËR NATO, POR A E KA VETEN?

F. 4



DIASPORA ARRIN REKORD REGJISTRIMESH PËR VOTIM NË ZGJEDHJET E 7 QERSHORIT

F. 5

AKTUALE



OBSH-ja E SHPALL EMERGJENCË GLOBALE SHËNDËTËSORE SHPËRTHIMIN E EBOLËS NË REPUBLIKËN DEMOKRATIKE TË KONGOS F. 2

HAMZA: QYTETARËT KANË NEVOJË PËR PAGA MË TË LARTA DHE ÇMIME MË TË ULËTA, JO PËR PROPAGANDË E PËRÇARJE F. 5

ZKA-ja GJEN NJË MORI SHKELJESH NË INSTITUCIONE PUBLIKE, 80 RASTE DËRGOHEN NË PROKURORI F. 6

EKONOMI



AKB-ja: KOSOVA PO FUNDOSËT EKONOMIKISHT, VENDI I DYTË MË I VARFËR NË EVROPË F. 8

SA TË SIGURTA JANË USHQIMET NË TREGUN E KOSOVËS? F. 8

SPORT



AFRIM OSMANAJ ZGJEDHET KRYETAR I FEDERATËS SË FUTBOLLIT SHQIPTAR NË GJERMANI, SHQIPTAR GUBETINI NËNKRYETAR F. 11

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OBSH-ja E SHPALL EMERGJENCË GLOBALE SHËNDETËSORE SHPËRTHIMIN E EBOLËS NË REPUBLIKËN DEMOKRATIKE TË KONGOS

GJENEVË, 18 MAJ - Shpërthim i virusit Ebola në Republikën Demokratike të Kongos dhe në Ugandë është shpallur emergjencë globale shëndetësore nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) të dielën, pas 80 vdekjeve të dyshuara dhe nëntë rasteve të konfirmuara laboratorikisht. OBSH-ja tha se ky shpërthim i Ebolës nuk i plotëson kriteret për të shpallur emergjencë pandemike, por vendet që ndajnë kufijtë tokësorë me Republikën Demokratike të Kongos janë në rrezik të lartë për përhapje të mëtejshme. Të dielën agjencia shëndetësore e OKB-së deklaroi në një komunikatë se deri të shtunën ishin raportuar 80 vdekje të dyshuara, tetë raste të konfirmuara laboratorikisht dhe 246 raste të dyshuara në provincën Ituri të Republikës Demokratike të Kongos, në të paktën tri zona shëndetësore, përfshirë Bunia, Rvampara dhe Mongbvalu. Rasti i nëntë u konfirmua në qytetin lindor kongolez të Gomës, sipas një deklarate të rebelëve të M23.

OBSH: Përhapja ndërkombëtare është dokumentuar

Ministria e Shëndetësisë e Republikës Demokratike të Kongos kishte deklaruar të

premtën se 80 njerëz kishin vdekur nga shpërthimi i ri në provincën lindore. Shpërthimi i 17 në vendin ku Ebola u identifikua për herë të parë në vitin 1976, mund të jetë në fakt shumë më i madh, duke pasur parasysh shkallën e lartë të pozitivitetit të mostrave fillestare dhe numrin në rritje të rasteve të dyshuara që po raportohen, tha OBSH-ja. Sipas saj, shpërthimi është "i jashtëzakonshëm" sepse nuk ekzistojnë terapi apo vaksina të miratuara specifike për virusin Bundibugio, ndryshe nga variantet Ebola-Zaire.

Të gjitha shpërthimet e mëparshme të vendit, përveç njërit, ishin shkaktuar nga varianti Zaire. Shpërthimi në Republikën Demokratike të Kongos dhe Ugandë paraqet rrezik për shëndetin publik edhe për vendet e tjera, pasi tashmë janë dokumentuar disa raste të përhapjes ndërkombëtare, tha agjencia, duke kështilluar vendet të aktivizojnë mekanizmat kombëtarë të menaxhimit të fatkeqësive dhe emergjencave, si dhe të kryejnë kontrolle ndërkufitare dhe kontrolle në rrugët kryesore të brendshme. Në Kampala, kryeqytetin e Ugandës, të premtën dhe të shtunën u raportuan dy raste të konfirmuara laboratorikisht, që duket se nuk kishin lidhje mes vete, përfshirë një vdekje, nga persona që kishin udhëtuar nga Republika Demokratike e



Kongos, tha OBSH-ja.

Një rast i konfirmuar laboratorikisht u raportua gjithashtu në Kinshasa, kryeqyteti i Republikës Demokratike të Kongos, nga një person që ishte kthyer nga Ituri, sipas OBSH-së. OBSH tha se personat që kanë qenë në kontakt me virusin Bundibugio ose rasteve të dyshuara nuk duhet të udhëtojnë ndërkombëtarisht, përveç rasteve të evakuimit mjekësor. Agjencia rekomandoi izolimin e menjëhershëm të rasteve të konfirmuara dhe monitorimin e përditshëm të kontakteve, me kufizim të udhëtimit brenda vendit dhe ndalim të

udhëtimit ndërkombëtar deri në 21 ditë pas ekspozimit. Në të njëjtën kohë, OBSH u bëri thirrje vendeve të mos mbyllin kufijtë ose të kufizojnë udhëtimin dhe tregtinë nga frika, pasi kjo mund të çojë në kalime joformale kufitare nga njerëzit dhe mallrat, të cilat nuk monitorohen. Pyjet e dendura tropikale të Republikës Demokratike të Kongos janë një rezervuar natyror për virusin Ebola. Jean Kaseya, drejtori i përgjithshëm i Qendrave Afrikane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, deklaroi në një komunikatë se

kishte kërkuar udhëzime teknike dhe rekomandime lidhur me nevojën e mundshme për ta shpallur shpërthimin emergjencë të shëndetit publik me rëndësi për sigurinë kontinentale. Virus, i cili është shpesh vdekjeprurës dhe shkakton temperaturë, dhimbje trupore, të vjella dhe diarje, përhapet përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me lëngjet trupore të personave të infektuar, materialeve të kontaminuara ose personave që kanë vdekur nga sëmundja, sipas Qendrave Afrikane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve.

AMNESTY: IRANI EKZEKUTOI MBI 2 000 PERSONA VITIN E KALUAR

TEHRAN, 18 MAJ - Irani ka ekzekutuar një numër "tronditës" prej 2 159 personash më 2025, u tha në raportin e Amnesty International të publikuar më 18 maj. Sipas organizatës për të drejtat e njeriut, numri i ekzekutimeve ka tejkaluar rekordin e vitit 1981 të regjistruar në këtë shtet. Amnesty International tha se të paktën 2 707 persona u ekzekutuan në mbarë botën vitin e kaluar, edhe pse dënimet me vdekje të shqiptuara në Kinë nuk janë përfshirë në këtë shifër. Organizata me seli në Londër tha se "mijëra ekzekutime" janë kryer në Kinë, shtetit që përdor më së shumti dënimin me vdekje. Megjithatë, sipas Amnesty detajet janë të paqarta për shkak të "sekretit shtetëror" mbi të dhënat në Kinë. Amnesty tha se shifra globale për vitin 2025 - që përfshijnë ekzekutimet në Arabinë Saudite, Kuvajt, Egjipt, Jemen, Singapor



dhe Shtetet e Bashkuara - paraqet rritje për më shumë se dy të tretat krahasuar me shifrën e përgjithshme më 2024. "Ky trend ishte më i theksuar në shtetet ku autoritetet kanë forcuar kontrollin mbi pushtetin, duke kufizuar hapësirën civile, duke heshtur disidencën dhe duke treguar

shpërfillje ndaj mbrojtjeve të vendosura nga ligjet dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut", u tha në deklaratë. Në veçanti, "rritja tronditëse e ekzekutimeve të regjistruara në Iran" erdhi në kohën kur autoritetet "intensifikuan përdorimin e dënimit me vdekje

si mjet shtypës politik dhe të kontrollit", veçanërisht pas luftës së qershorit të vitit 2025 me Izraelin. Amnesty dhe grupe të tjera për të drejtat e njeriut kanë thënë se Teherani po intensifikon përdorimin e dënimit me vdekje pas protestave masive antiqeveritare në janar dhe luftës që më pas shpërtheu ndaj Izraelit dhe Shteteve të Bashkuara. Organizata tha se 2.159 ekzekutime janë regjistruar në Iran më 2025 dhe kjo shifër "përbën shifrën më të lartë që nga viti 1981" që është regjistruar në këtë shtet. Po ashtu, kjo është shifra më e lartë e regjistruar në një shtet të vetëm që nga ai vit. Për shkak të vështirësisë për marrjen e informacioneve konkrete, grupe të tjera kanë ofruar shifra të tjera sa u përket ekzekutimeve në Iran. Organizata joqeveritare Të

Drejtat e Njeriut Iran - organizatë me seli në Norvegji - më herët gjatë vitit tha se të paktën 1.639 persona ishin ekzekutuar në Iran vitin e kaluar. Teherani e ka pranuar se ka ekzekutuar 30 persona deri më tani gjatë këtij viti. Arabia Saudite vitin e kaluar kreu të paktën 356 ekzekutime, që është shifër më e lartë sesa rekordi i regjistruar më 2024 prej të paktën 345 ekzekutimesh, tha Amnesty. Ekzekutimet në Kuvajt u rritën nga gjashtë më 2024 në 17. Në Egjipt, nga 13 numri i ekzekutimeve u rrit në 23. Në Jemen, shifrat vjetore u rritën nga 38 në të paktën 51. Ndërkaq, në ShBA, Amnesty tha se ka pasur një "ritje të paprecedent" të ekzekutimeve në Floridë - ku janë regjistruar 19 dënime me vdekje - duke bërë që numri i përgjithshëm të arrijë në 47, që paraqet shifrën më të lartë që nga viti 2009.

PARAFUSHATË ME AKUZA E PËRPLASJE FIZIKE

PRISHTINË, 18 MAJ - Më pak se dy javë para nisjes së fushatës zyrtare për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë, skena politike është përfshirë nga akuza të ndërsjella për shantazh, presione, keqpërdorim të burimeve shtetërore...

Ndërsa partitë kryesore shqiptare fajësojnë njëra-tjetrën për krizën institucionale që ka çuar në zgjedhje të reja, në terren është regjistruar edhe një përplasje fizike mes kundërshtarëve politikë.

Aktivistët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile paralajmërojnë se dhuna është e papranueshme, përbën vijë të kuqe dhe nuk duhet - në asnjë mënyrë - të bëhet mjet për ardhje në pushtet.

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë do të mbahen më 7 qershor, pasi Kuvendi i Kosovës nuk ka arritur ta zgjedhë presidentin e ri brenda afateve kushtetuese. Ato do të jenë zgjedhjet e treta parlamentare brenda 18 muajsh, pas atyre të mbajtura në shkurt dhe dhjetor të vitit 2025.

Akuza për dhunë

Lëvizja Vetëvendosje e Albin Kurtit, deri tani në pushtet, ka njoftuar më 14 maj se kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku - nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës - së bashku me truporët e tij, kanë sulmuar kandidatin e saj për deputet, Hysni Mehani, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore.

Lushtaku, në anën tjetër, ka pretenduar se kryeministri në detyrë, Albin Kurti, përmes "mekanizmave" të tij në Skenderaj, ka tentuar ta sulmojë atë. "E kam një jetë në shërbim të vendit, kurse etiketat si 'Sami Serbia', qytetarët nuk i tolerojnë më, prandaj edhe reagon!" ka shkruar Lushtaku në Facebook. Lideri i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka deklaruar se Policia Speciale e Kosovës ka ndërhyrë në Drenicë më 14 maj, "me urdhër të Qeverisë së Kosovës", për të demonstruar "forcë".

Përmes një postimi në "Facebook", ai i ka bërë thirrje Kurtit që të ndalë propagandën, gjuhën e urrejtjes dhe provokimet, si dhe "keqpërdorimin e shtetit për skenarë partiakë". Por, Policia e Kosovës ka thënë se bëhet fjalë për një kontroll rutinë dhe se nuk ka vend për shqetësim.

Për përfaqësuesit e shoqërisë civile, sulmet fizike ndaj kundërshtarëve politikë përbëjnë "vija të kuqe" për çdo



shoqëri demokratike dhe janë të papranueshme e të dënueshme.

"...andaj, nuk guxojnë të normalizohen apo të trajtohen si pjesë e zakonshme e klimës parazgjedhore", sipas Eugen Cakollit nga Instituti Demokratik i Kosovës (IDK). "Pas ngjarjeve të tilla, nuk duhet të ketë 'por'. Debatimi mbi gjuhën, polarizimin apo klimën e tensionuar politike në Kosovë është tejte i rëndësishëm dhe duhet të zhvillohet, pasi degradimi i vazhdueshëm i diskursit publik bart pasoja serioze...", ka shkruar Cakolli në Facebook. "Partitë politike, institucionet dhe vetë politikanët kanë përgjegjësi të refuzojnë polarizimin, gjuhën fyese, komunikimin agresiv dhe dhunën", sipas Ismet Kryeziut, po nga IDK-ja.

Sipas Ehat Miftarajt nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, Partia Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje, në mungesë të programeve apo ofertave për qeverisje, "kanë vendosur që përmes argumentit të boksit, forcës, sharjes dhe ofendimit të komunikojnë me qytetarin". "Dhuna, asnjëherë, nuk duhet pranuar si mjet komunikimi. Dhuna e çfarëdo lloji qoftë, fizike apo virtuale, nuk duhet të përdoret si mjet për pushtet. Organet e drejtësisë duhet ta trajtojnë këtë rast me paanshmëri dhe me forcën e ligjit, nëse guxojnë", ka shkruar Miftaraj në Facebook.

Akuza për "negociata të fshehta me Serbinë"

Ish-presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, bartëse e listës së Lidhjes Demokratike të

Kosovës si kandidate për presidente, ka akuzuar publikisht Kurtin se ka zhvilluar "negociata të fshehta" - pas dyerve të mbyllura - me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, dhe ish-emisarin e Bashkimit Evropian për dialogun Prishtinë-Beograd, Mirosllav Lajçak.

Osmani është larguar nga LDK-ja në vitin 2021 për t'u bashkuar në koalicion me Kurtin dhe Lëvizjen Vetëvendosje. Megjithatë, mungesa e mbështetjes nga Vetëvendosja për mandatin e dytë presidencial i ka përkeqësuar marrëdhëniet mes tyre.

Nga LDK-ja, po ashtu, kanë thënë se në rrjetet sociale po zhvillohet një fushatë e koordinuar kundër kandidatëve të saj për deputetë, përmes "profileve të rreme", dhe kanë paralajmëruar se për këtë çështje do të njoftohet edhe Policia e Kosovës.

Rashiqi akuzon Listën Serbe për presion dhe frikësim

Akuza të ndërsjella, para nisjes zyrtare të fushatës, ka edhe mes partive që përfaqësojnë komunitetin serb në Kosovë. Lideri i Partisë për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, Nenad Rashiq, ka akuzuar Listën Serbe për ushtrim presioni dhe frikësim të mbështetësve të tij.

Lista Serbe vepron me mbështetjen e Beogradit zyrtar, ndërsa Rashiq konsiderohet partner i Qeverisë së Albin Kurtit, ku mban edhe postin e ministrit për Komunitete dhe Kthim. Ai i ka bërë këto akuza gjatë një mbledhjeje të Qeverisë në

detyrë më 14 maj, duke u bërë thirrje institucioneve kompetente të Kosovës që të reagojnë.

Sipas tij, simpatizantët dhe anëtarët e partisë së tij po ndalohen në pikat kufitare me Serbinë nga Agjencia për Siguri dhe Informim e Serbisë (BIA), ndërsa rreth 20 persona të punësuar në institucionet e Serbisë në Kosovë, janë larguar nga puna. "Javën e kaluar ka pasur raste kur grupe të organizuara punëtorësh nga institucionet serbe, janë detyruar - nën presion dhe kërcënimin e largimit nga puna - të shkojnë në objekte në anën tjetër të pikës kufitare në Merdare, ku janë mbajtur për disa orë në hapësira të errëta, madje edhe në bodrume, dhe u është kërkuar të sqarojnë saktë se për kë do të votojnë më 7 qershor", ka deklaruar Rashiq.

Përgjigja e Listës Serbe

Në përgjigje të këtyre akuzave, Lista Serbe ka deklaruar se bëhet fjalë për përpjekje për të siguruar alibi për humbjen e mundshme në zgjedhje, duke pretenduar se Rashiq "nuk ka ide, plane dhe kandidatë me integritet" dhe se asnjëherë nuk e ka pasur "legjitimitetin e popullit serb".

Në zgjedhjet e fundit, të mbajtura në dhjetor të vitit të kaluar, Lista Serbe ka fituar nëntë nga dhjetë mandatet e rezervuara për komunitetin serb në Kuvendin e Kosovës, ndërsa një mandat e ka siguruar partia e Rashiqit. "Mësa duket, vendet e dhëna në komisionet komunale zgjedhore, ndërmarrjet publike, si dhe përpjekjet për të keqpërdorur mjetet nga

ministra që ai drejton, nuk po i japin rezultatet e pritura", është thënë në reagimin e Listës Serbe.

Kjo parti, gjithashtu, e ka akuzuar Rashiqin se ka heshtur përballë "shtypjes" së serbëve nga autoritetet e Kosovës, të udhëhequra nga Albin Kurti.

Edhe në ciklet e mëparshme zgjedhore, këto dy subjekte kanë shkëmbyer akuza për përdorim të burimeve shtetërore - si nga Kosova, ashtu edhe nga Serbia - për "blerje votash".

Lista Serbe është akuzuar se siguron vota përmes konkurseve për punësim në sektorin shëndetësor dhe përmes ndihmës financiare për të papunët nga buxheti i Serbisë.

Rashiq, në anën tjetër, është akuzuar se siguron vota përmes shpërndarjes së pajisjeve shtëpiake, materialeve ndërtimore dhe subvencioneve bujqësore nga Qeveria e Kosovës.

Përveç Listës Serbe dhe Partisë për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, për zgjedhje ka aplikuar edhe iniciativa qytetare "Bashkë fitojmë", por Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Kosovës nuk e ka certifikuar këtë listë, me arsyetimin se nuk ka siguruar numrin e mjaftueshëm të votave të vlefshme.

Nga kjo iniciativë, që përbëhet nga gjashtë subjekte opozitare serbe - Lëvizja Popullore Serbe, Aleanca Kosovare, Fytyra e Re, Demokracia Serbe, Veriu për të Gjithë dhe Rrënjët - është bërë e ditur për Radion Evropa e Lirë se, më 15 maj, kanë paraqitur ankesë dhe presin që KQZ-ja ta rishqyrtojë vendimin.



KOSOVA KA ALEATË PËR NATO, POR A E KA VETEN?

Në Kongresin Amerikan po merr formë një angazhim i shtuar për ta shtyrë përpara anëtarësimin e Kosovës në NATO. Dy rezoluta të reja - që prekin praninë ushtarake amerikane dhe perspektivën euroatlantike të Kosovës - e çojnë këtë angazhim përtej deklaratave. Por, pse pikërisht tani, kur prioritetet e ShBA-së duken diku tjetër dhe çfarë efekti real mund të ketë?

Prishtinë, 18 maj - Mes një bote në kaos dhe riorganizim, siguria është kthyer në prioritet absolut, dhe për Kosovën, ajo lidhet drejtpërdrejt me NATO-n - aleancën më të madhe ushtarake në botë. Një momentum i ri për afrimin e saj me të është duke u konsoliduar në qendrat e vendimmarrjes në Uashington, megjithatë shfrytëzimi i tij duket se kërkon shtytje më të fortë politike edhe nga Prishtina. Për ish-ministrin e Mbrojtjes së Shqipërisë, Fatmir Mediu, i përfshirë nga afër në bisedimet për avancimin e Kosovës drejt NATO-s, mbështetja nga Uashingtoni përbën një mundësi të rëndësishme. Por, sipas tij, ajo humbet peshë nëse Kosova nuk siguron stabilitet të brendshëm institucional. Anëtarësimi në NATO kërkon, para së gjithash, konsensus politik dhe qasje të koordinuar nga vetë Kosova. "Pa një Kosovë me institucione, pa një

Kosovë me politikë dhe Qeveri të qëndrueshme, do të jetë e vështirë të hapësh rrugën që duhet për anëtarësimin në NATO", thotë Mediu për programin Expose të Radios Evropa e Lirë. Në fund të prillit, në Kongresin Amerikan u hodh një hap konkret: përfaqësuesi Keith Self, bashkë me kolegët e tij, Ritchie Torres dhe Mike Lawler, propozuan një rezolutë që synon ta shtyjë përpara rrugën e Kosovës drejt NATO-s. Rezoluta me mbështetje dypartiake thekson, mes të tjerash, se "qeverisja demokratike e Kosovës, mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë dhe bashkëjetesa shumëetnike përbëjnë një argument bindës për anëtarësimin në NATO". Aty, po ashtu, thuhet se "përfshirja e Kosovës në aleancën e NATO-s do të shërbente si një kundërpeshë e nevojshme për të dekurajuar përpjekjet armiqësore dhe për të parandaluar një katastrofë

tjetër globale në Ballkan". Dhe kjo nuk është nisma e vetme. Një tjetër rezolutë në Kongres, e iniciuar po në fund të prillit nga Torres, Self dhe kongresisti George Latimer, e vendos theksin te prania ushtarake e Shteteve të Bashkuara në Kosovë, duke e cilësuar atë si kyç për stabilitetin në rajon. Gjatë një mbledhjeje të kësaj jave të Komitetit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve, Self ka theksuar sërish se Kosova ka dëshmuar përkushtim të qartë ndaj stabilitetit rajonal dhe përafrimit strategjik me NATO-n, ndaj edhe duhet të jetë pjesë e saj. "Kosova është, padyshim, një nga partnerët më të afërt dhe më besnikë evropianë të Shteteve të Bashkuara. Në një periudhë të shkurtër kohe, ky shtet i ri ka dëshmuar përkushtim të qartë ndaj qeverisjes demokratike, kontrollit civil mbi forcat e sigurisë dhe bashkëjetesës shumëetnike - të gjitha këto e përforcojnë argumentin për anëtarësim në NATO dhe për stabilitet në Ballkan", ka thënë Self në seancën e 13 majit. Nga kabineti i kongresistit Torres është shprehur po ashtu mbështetje për anëtarësimin e Kosovës në NATO, por dhe për vazhdimin e pranisë së ShBA-së në misionin paqeruajtës KFOR. "Kongresi shpreson që të shohë anëtarësimin e Kosovës në NATO, mbështetje dypartiake për të mbajtur nivelin e forcave në KFOR dhe procesin e dialogut që nuk e

shpërblen Serbinë me lëshime dhe kokëfortësi", ka thënë për Radion Evropa e Lirë zëdhënësi i Torresit, Benny Stanislawski. Qeveria e Kosovës nuk u është përgjigjur pyetjeve të Radios Evropa e Lirë për mënyrën se si i interpreton ajo rezolutat e fundit në Kongresin amerikan, për komunikimet eventuale me ShBA-në apo NATO-n, si dhe për vlerësimin e pozicionit aktual të Kosovës në procesin e integrimi euroatlantike. Zyra e NATO-s në Bruksel tha vetëm se çdo hap i mëtejshëm për të konsoliduar marrëdhëniet e aleancës me institucionet në Kosovë, kërkon konsensus nga të gjithë aleatët. "Ne i inkurajojmë institucionet në Kosovë që të konsolidojnë qeverisjen e mirë, për të mirën e të gjithë njerëzve që jetojnë në Kosovë. NATO-ja mbetet plotësisht e përkushtuar ndaj stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, përfshirë edhe përmes misionit KFOR", tha një zëdhënësi i aleancës për Radion Evropa e Lirë. Politika e "dyerve të hapura" e NATO-s bazohet në Nenin 10 të Traktatit të Uashingtonit, i cili përcakton se anëtarësimi është i hapur për çdo "shtet evropian që është në gjendje t'i çojë përpara parimet e këtij Traktati dhe të kontribuojë në sigurinë e zonës së Atlantikut të Veriut". Kosova e ka të deklaruar prej kohësh synimin për anëtarësim në aleancë dhe ka

ndërmarrë hapa në ndërtimin e kapaciteteve të sigurisë në përputhje me standardet e saj, por procesi mbetet i bllokuar në aspektin politik, pasi katër vende anëtare të NATO-s nuk e njohin ende pavarësinë e Kosovës, dhe çdo zgjerim i ri kërkon konsensusin e të 32 aleatëve. Radio Evropa e Lirë ka kontaktuar ministritë e Jashtme të këtyre katër vendeve - Spanjës, Greqisë, Sllovakisë dhe Rumanisë - për t'i pyetur nëse po shqyrtojnë rishikimin e qëndrimit të tyre ndaj njohjes së pavarësisë së Kosovës. Prej tyre është deklaruar vetëm Ministria e Jashtme e Sllovakisë, duke theksuar se qëndrimi i saj mbetet i bazuar në Deklaratën e Parlamentit të vitit 2007, e cila e lidh zgjidhjen e statusit të Kosovës me respektimin e kërkesave të Serbisë dhe normave të së drejtës ndërkombëtare, si dhe me rezultatin e dialogut Prishtinë-Beograd, të lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Vëzhguesit thonë se, pavarësisht qëndrimeve të ngurta të shteteve mosnjohëse, rezolutat në Kongresin amerikan - edhe pse joobliguese - e pengojnë Kosovën "të zhytet në harresë". Me fjalët e Mediu, ky angazhim lidhet edhe me interesin e ShBA-së për të ruajtur ekuilibrat në Ballkan dhe për të parandaluar rritjen e ndikimeve ruse, kineze dhe

HAMZA: QYTETARËT KANË NEVOJË PËR PAGA MË TË LARTA DHE ÇMIME MË TË ULËTA, JO PËR PROPAGANDË E PËRÇARJE

PRISHTINË, 18 MAJ - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, ka vizituar familjen e Afrim Mexhuanit në Obiliq. Ai ka bërë me dije se gjendja ekonomike dhe vështirësitë e qytetarëve janë bërë të papërballueshme për shumë familje në Kosovë. Hamza ka shtuar se gjatë vizitës ka dëgjuar nga afër shqetësimet me të cilat përballen qytetarët çdo ditë, duke përmendur rritjen e çmimeve, pagat e ulëta dhe mungesën e perspektivës. "Jeta në Kosovë është bërë e vështirë për shumë familje. Në Obiliq, te familja e Afrim Mexhuanit, dëgjova nga afër brengat që sot i kanë mijëra qytetarë: çmime

të larta, paga të pamjaftueshme dhe mungesë perspektive", ka deklaruar Hamza.

Ai ka kritikuar qasjen e qeverisë aktuale, duke thënë se vendi nuk ka nevojë për "propagandë e përçarje", por për institucione që merren me problemet reale të qytetarëve. Sipas Hamzës, Kosova ka nevojë për politika që sigurojnë paga më të larta, çmime më të ulëta dhe më shumë dinjitet për familjet e Kosovës.

Në fund të mesazhit të tij, kandidati i PDK-së ka bërë thirrje për ndryshim në zgjedhjet e 7 qershorit. "Më 7 qershor, ta bëjmë bashkë kthesën e madhe", ka përfunduar ai.



Diaspora arrin rekord regjistrimesh për votim në zgjedhjet e 7 qershorit



PRISHTINË, 18 MAJ - Deri më tani janë aprovuar gati 110 mijë kërkesa të diasporës për votim në zgjedhjet e 7 qershorit 2026. Edhe pse mbi 25 mijë kërkesa mbeten ende në shqyrtim, ky tashmë është numri më i lartë i regjistruar për votim nga jashtë në një proces zgjedhor në Kosovë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se më 17 maj, në orën 23:59, është mbyllur periudha e aplikimit për regjistrimin e votuesve jashtë Kosovës për pjesëmarrje në zgjedhjet e

parakohshme për Kuvendin e Kosovës.

Gjatë periudhës 6-17 maj 2026 shtetasit e Kosovës që jetojnë jashtë vendit kanë mundur të aplikojnë për regjistrim përmes platformës elektronike: diaspora.kqz-ks.org dhe përmes postës, duke dërguar aplikimin në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë.

Sipas të dhënave preliminare: Janë pranuar gjithsej 142 803 kërkesa për regjistrim, 109 696 janë aprovuar, 7 325 janë refuzuar, 25 702 mbeten në

shqyrtim. Nga aplikimet e aprovuara: 81 901 votues janë regjistruar për dërgimin e fletëvotimit në kuti postare jashtë Kosovës; 2 855 për dërgimin në kutinë postare të KQZ-së në Kosovë; 24 940 janë regjistruar për votim fizik në përfaqësi diplomatike.

Ndërkaq votimi në përfaqësi diplomatike mbahet më 6 qershor 2026, nga ora 07:00 deri në 19:00 sipas kohës lokale, kurse votimi përmes postës zhvillohet nga 25 maj deri më 6 qershor 2026.

serbe në rajon. "Unë kam bindjen se Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pavarësisht nga retorika, NATO-n e shikojnë si një element jashtëzakonisht të rëndësishëm, jo vetëm për stabilitetin e Ballkanit, por edhe për një marrëdhënie dhe një influencë më të gjerë gjeopolitike. Dhe, në këtë kuadër, padyshim që është dhe interesi për Kosovën", thotë Mediu.

Ish-zyrtari i lartë i NATO-s, Jamie Shea, vlerëson se aktivizmi në Kongresin amerikan duhet kuptuar më shumë si vendosje e një agjende afatgjatë, sesa si ndikim i menjëhershëm. Ai thotë se kjo e mban Kosovën në vëmendjen politike të Uashingtonit dhe krijon hapësirë për një mundësi të ardhshme, kur kushtet në marrëdhëniet Kosovë-Serbi dhe brenda vetë NATO-s të jenë më të favorshme. "Por, sinqerisht, derisa të ketë stabilitet politik në Kosovë, sepse tri palë zgjedhje në 18 muaj nuk janë shenjë e mirë...

ndaj, derisa të ketë më shumë stabilitet pas zgjedhjeve të qershorit, nuk pritët të ketë një rrugë të qartë përpara në procesin e integritetit euroatlantik", thotë Shea për Exposenë.

Kosova, në më pak se një muaj, do të mbajë zgjedhjet e treta parlamentare brenda një periudhe prej një viti e gjysmë, pasi dy ciklet e mëparshme nuk arritën të prodhojnë institucione të qëndrueshme, për shkak të mungesës së konsensusit mes partive politike.

E, Mediu argumenton se anëtarësimi në NATO nuk varet vetëm nga mbështetja amerikane, por edhe nga koordinimi politik dhe angazhimi i brendshëm i vetë Kosovës, në bashkëpunim me aleatët.

Në këtë kontekst, ai nënvizon nevojën për shtim të aktivitetëve diplomatike dhe lobuese, veçanërisht në Uashington, si dhe për reforma të strukturuar sipas standardeve të NATO-s, duke

kujtuar se një rrugëtim i ngjashëm i ka paraprirë edhe anëtarësimi të Shqipërisë në NATO në vitin 2009. "Unë mendoj që është një nga zhvillimet më të mira që kanë ndodhur për Kosovën. Për disa arsye... sepse, po të kujtojmë historinë tonë, kështu ka filluar - me deklarata, me rezoluta në Kongresin amerikan. Në qoftë se vijmë, pastaj, në një aprovim të rezolutës në Kongres, ajo kthehet në një gjë që përcakton edhe politika të Departamentit amerikan të Shtetit apo të administratës amerikane", thotë Mediu.

Ai shton se Shtetet e Bashkuara kanë peshë vendimtare në vendimmarrjen e NATO-s dhe se do të ishte e vështirë që disa vende anëtare t'i rezistonin presionit amerikan, nëse Uashingtoni do të këmbëngulte në anëtarësimin e Kosovës.

Gjatë mbledhjes së Komitetit për Punë të Jashtme, më 13 maj, kongresisti Self kërkoi bllokimin e 1.8 miliard dollarëve ndihmë ushtarake

për Greqinë, derisa Athina ta njohë pavarësinë e Kosovës, duke paraqitur edhe një amendament për ndalimin e kësaj ndihme vjetore, por që u kundërshtua nga disa përfaqësues demokratë. Shea pajtohet se mbajtja nën presion e shteteve mosnjohëse është e rëndësishme, por shton se Kosova nuk mund të mbështetet vetëm te ShBA-ja, duke theksuar nevojën për një qasje më të balancuar drejt Evropës. "Kosova duhet të ketë një përpjekje më të balancuar lobimi dhe të llojë po aq fort në Berlin, Paris, Londër apo Varshavë, sa edhe në Uashington. Mbështetja vetëm te Shtetet e Bashkuara mund të ketë funksionuar në të kaluarën, në vitet '90, por sot nuk është më një strategji efektive", vlerëson Shea.

Në një linjë të ngjashme, edhe Daniel Serwer, nga Universiteti Johns Hopkins në Uashington, vë në dukje kufizimet reale të ndikimit të Kongresit amerikan në këtë

proces. "Rezolutat sugjerojnë mbështetje të konsiderueshme politike për anëtarësimin e Kosovës në NATO, por ato nuk e detyrojnë administratën. Presidenti mund t'i injorojë ato. Autoriteti i tij në politikën e jashtme është praktikisht i pakufizuar", thotë Serwer për Exposenë.

Në një kohë kur rendi botëror po rishkruhet dhe balancat e sigurisë po lëkundën, Shtetet e Bashkuara po sinjalizojnë qartë edhe riorganizim të pranisë së tyre ushtarake në Evropë - deri te tërheqja e mijëra trupave nga Gjermania. Në këtë realitet të ri, merr peshë pikërisht ajo që thekson Mediu: prania amerikane në KFOR nuk është thjesht ushtarake - është një mesazh i fortë politik për angazhimin e SHBA-së në rajon. Dhe Kosova, nëse synon ta shfrytëzojë këtë dritare gjeopolitike, duhet të dalë nga logjika e politikës ditore dhe të kalojë në veprim strategjik afatgjatë.

Zhbllkohet ndërtimi i sheshit 'Xhorxh Bush', IKMM u jep dritë të gjelbër punimeve

PRISHTINË, 18 MAJ - Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (IKMM) ka miratuar kërkesën e Drejtorisë për Transformim të Komunës së Prishtinës, duke dhënë pëlqimin për realizimin e punimeve të infrastrukturës nëntokësore në sheshin "Xhorxh Bush".

Ish-drejtori i Transformimit në Komunën e Prishtinës, Gëzim Kastrati, e ka cilësuar këtë vendim si një hap i rëndësishëm për vazhdimin e projektit. "Një superlajm për kryeqytetin drejt zhvillimit të projektit 'Xhorxh

Bush'. Miratohet kërkesa e parashtruar nga Drejtoria për Transformim - komuna e Prishtinës për pëlqim për punimet e infrastrukturës nëntokësore në sheshin 'Xhorxh Bush', ka shkruar Kastrati.

Ai ka vlerësuar vendimin e Komisionit të IKMM-së dhe të Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë (QRTK), duke thënë se institucionet kanë mbajtur një qasje profesionale ndaj projektit.

"Një vendim i shumëpritur dhe konstruktiv i Komisionit të

Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve dhe Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë, me ç'rast i përgëzoj për qëndrimin profesional ndaj këtij projekti shumë të rëndësishëm për krijimin e hapësirave publike kualitative në dobi të qytetarëve dhe Kryeqytetit", ka shtuar ai. Sipas Kastratit, ditë më parë ka arritur edhe një sasi e konsiderueshme e shtresës finale të granitit, ndërsa së shpejti pritet të nisë implementimi i saj në terren.



AGJENCIA E METROLOGJISË SË KOSOVËS NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME AGJENCITË HOMOLOGUE TË SHQIPËRISË DHE MAQEDONISË SË VERIUT

PRISHTINË, 18 MAJ - Në Ditën Botërore të Metrologjisë, Agjencia e Metrologjisë së Kosovës ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit ndërmjet Agjencive të Metrologjisë së Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, ka bërë me dije se këto marrëveshje përfaqëson një hap të rëndësishëm në avancimin e sektorit të metrologjisë dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal ndërmjet tri vendeve. Ajo

theksoi se Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar në ndërtimin e një sistemi modern dhe të besueshëm metrologjik, të harmonizuar me standardet dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Ministrja bëri me dije se gjatë tre muajve të fundit janë inkuorporuar direktivat evropiane që ndërlidhen me metrologjinë, përmes plotësim-ndryshimit të Ligjit për Metrologjinë dhe Rregullores për Mjetet Matëse ligjërisht të kontrolluara.

Po ashtu, ajo njoftoi se për vitin aktual janë planifikuar investime



në vlerë prej 600 mijë eurosh për laboratorë modernë, pajisje të avancuara dhe etalonë shtetërorë, investime që synojnë

mbështetjen e industrisë, rritjen e kapaciteteve eksportuese dhe mbrojtjen e konsumatorit. Ndër investimet prioritare,

ministrja Kusari-Lila përmendi edhe pajisjen me sisteme për verifikimin e radarëve inteligjentë dhe mobilë, të cilat kanë rëndësi të veçantë për sigurinë në trafik dhe forcimin e kontrollit metrologjik. Sipas saj, Agjencia e Metrologjisë së Kosovës ka nisur gjithashtu procesin e digitalizimit të shërbimeve, i cili përfshin aplikimin online për verifikim dhe kalibrim, shpërndarjen elektronike të certifikatave dhe raporteve, si dhe krijimin e platformave moderne për shërbime metrologjike.

ZKA-ja GJEN NJË MORI SHKELJESH NË INSTITUCIONE PUBLIKE, 80 RASTE DËRGOHEN NË PROKURORI

PRISHTINË, 18 MAJ - Zyra Kombëtare e Auditimit ka gjetur një mori shkeljesh në institucionet dhe ndërmarrjet publike në Kosovë. Si pasojë e dyshimeve për keqpërdorime, ZKA-ja gjatë vitit 2025 ka dërguar 80 raste në Prokurorinë e Shtetit. Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, ka renditur mangësitë në procedurat e prokurimit publik, përkatesisht vlerësimin e ofertave, shpërbllimin me kontratë për operatorin ekonomik pa i plotësuar kriteret, përdorimin e referencave ndaj një marke brendi të caktuar pa



përdorimin e shprehjes ekuivalent, e shumë mangësi të tjera. "Mangësi në përgatitjen e para masës në projektet kapitale. Moszbatimi i procedurave të

prokurimit publik me rastin e angazhimit të punonjësve për shërbime të veçanta. Ndryshime të ndarjeve buxhetore për projekte kapitale pa miratim të Kuvendit Komunal. Lidhja e 6 kontratave në vlerë prej 50 mijë euro për shfrytëzimin e hapësirave reklamuese nga mediat e portalet pa procedurë të prokurimit publik. Vonesa në implementimin e projekteve kapitale dhe mos zbatimin e ndëshkimeve për vonesa. Mospagesa e faturave/obligimeve ndaj operatorëve ekonomik brenda afatit ligjor. Mungesa e

monitorimit të subvencioneve të dhëna në fushën e bujqësisë. Përzgjedhja e OJQ-ve në kundërshtim me kriteret në Thirrjen Publike. Angazhimi i shërbimeve të auditimit nga auditori privat, për kundër faktit se ndërmarrja ishte subjekt i auditimit nga ZKA. Mospërditësimi i kontratave të të punësuarve, bazuar në vendimet e Bordit, për rritjen e pagës dhe vlerën e saktë të shujtës. Mbajtja e pozitave të rregullta me ushtrues detyre përtej afatit ligjor. Mos menaxhimi i kontratave përmes platformës së prokurimit

(E-prokurimi). Moshartimi dhe përditësimi i rregullores sipas kërkesave ligjore për afarizmin e ndërmarrjes", ka thënë Spanca. Sipas saj, gjatë këtij sezoni auditues janë planifikuar 145 auditime dhe deri tani janë publikuar 24 raporte. Ajo ka thënë se tetë institucione kanë marrë opinion të kualifikuar për shkak të keqdeklarimeve materiale dhe raportimit jo të plotë. Sipas Spancës, edhe ndërmarrjet publike kanë shfaqur mangësi serioze në raportimin financiar.

PSD-ja me aksion para zyrave të PDK-së dhe LDK-së, ka dy pyetje për këto parti

PRISHTINË, 18 MAJ - Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka zhvilluar një aksion para zyrave të PDK-së dhe LDK-së, ku ka vendosur një pankartë me mbishkrimin "zotim publik", përmes së cilës ka kërkuar nga këto parti që të deklarohen publikisht për qëndrimet e saj pas zgjedhjeve dhe të mos hyjnë në marrëveshje me pushtetin aktual.

Molliqaj ka thënë se qytetarët presin përgjigje për arsyen pse vendi ka shkuar në zgjedhje

dhe çfarë do të ndodhë pas tyre. "Dy pyetje presin përgjigje nga qytetarët e Republikës së Kosovës. Janë jetike për këto zgjedhje: Pse shkuam në zgjedhje dhe çfarë do të ndodhë pas këtyre zgjedhjeve? Pa shpjegimin e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të Partisë Demokratike të Kosovës për këto dy pyetje, nuk mundet qytetari për të kuptuar se çfarë po ndodh dhe çfarë ka për të ndodhur", ka thënë ai. Ai ka deklaruar se refuzimi i deritanishëm për

bashkëpunim me kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, nuk ka qenë parimor, por i lidhur me pushtetin. "Në leximin tonë, ka qenë i drejtë refuzimi për bashkëpunim me Kurtin sa i përket zgjedhjes së presidentit. Rugës po kuptojmë që ky refuzim nuk ka qenë parimor, nuk ka qenë normativ, por ka qenë për pushtet. Tani pyetja e dytë është çfarë duan këto parti për të bërë pas zgjedhjeve që t'i kuptojmë a me i votua në zgjedhje", ka thënë Molliqaj.



Në praninë e Bill Clintonit dhe Hillary Clintonit, u nderua figura e Eliot Engelit në Nju-Jork

PRISHTINË, 18 MAJ - Në Lehman College në New York City është mbajtur mbrëmë një mbledhje përkujtimore në nderim të ish-kongresistit amerikan Eliot Engel, ku morën pjesë personalitete të shumta politike e shoqërore shqiptaro-amerikane. Lidhur me këtë ngjarje ka shkruar shefi i Misionit në Konsullatën e Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju-

Jork, ambasadori Blerim Reka, i cili bëri të me dije se në këtë publik memorial servis morën pjesë ish-presidenti amerikan Bill Clinton, ish-sekretarja e shtetit Hillary Clinton, kongresistët Ritchie Torres, George Latimer e Jerrold Nadler, si dhe guvernatorja e shtetit të Nju-Jorkut Kathy Hochul. “Në këtë public memorial service, nderuam jetën dhe veprën e kongresistit Eliot

Engel, në veçanti mbështetjen e tij tridekadëshe për Kosovën. Çfarëdo që thuhet, është pak për të përmbledhur tërë kontributin e tij në Kongresin Amerikan, në vitet më të vështira për shqiptarët. Urojmë që nisma për emërtimin e ambasadës së SHBA në Prishtinë me emrin e tij, të jetësohet shpejt. Lavdi kongresistit Engel!”, ka shkruar Reka në “Facebook”.



ME KËRKESË TË ALBULENA HAXHIUT, KPK-ja SHPALL KONKURS PËR ZGJEDHJEN E KRYEPROKURORIT TË SHTETIT

PRISHTINË, 18 MAJ - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) në mbledhjen e mbajtur të hënën ka shpallur konkursin për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit.

Shpallja e këtij konkursi është bërë me pesë vota për, një kundër dhe asnjë abstenim.

Anëtari i KPK-së, Milot Krasniqi, ka thënë se procesi për Kryeprokuror të Shtetit është bllokuar tash e katër vjet qëllimisht, duke bërë me dije se në këtë proces KPK-ja duhet të tregojë integritet dhe të mos zhvillojë procese nën ndikim të dikujt.

Krasniqi ka theksuar se para publikut do të parashtrijë disa pyetje se kujt i pengoi dekretimi i Kryeprokurorit të Shtetit dhe se a duhet me domosdo ta kemi Kryeprokurorin që e duan pushtetet tjera.

Krasniqi ka deklaruar se ish-presidentja Vjosa Osmani mori rolin e arbitrit kur nuk dekretoi Blerim Isufajn për Kryeprokuror të Shtetit, duke



shtuar se nuk ka vendim por vetëm një njoftim për mosdekretim, e të cilin tha se nuk e ka si anëtar i KPK-së. Po ashtu, Krasniqi ka thënë se në Këshill ka mbërritur një letër nga ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, duke kërkuar që të shpallet konkursi, duke shtuar se një qasje e tillë është e papranueshme dhe se nënkuptohet si ndërhyrje në

punën e KPK-së.

Ndërkaq vetë kryesuesi Arian Gashi ka thënë se nuk përfshihet në diskutime që përfshihen aspekte të pushteteve të tjera, duke shtuar se kjo pozitë tash e një kohë është me ushtrues detyre. Më pas, mori fjalën Krasniqi, duke thënë se kush është presidenti që të përfshihet në diskutime “se kur duhet ta shpallin konkursin” duke

kërkuar që të mos ketë ndikim. Ai ka kërkuar që procesin ta zhvillojnë të vetëm, duke mos kërkuar që të përzihet dikush tjetër. Kurse Gashi ka thënë se e vetmja pozitë që nevojitet dekret prej presidentit të shtetit është ajo e Kryeprokurorit të Shtetit dhe se pa një dekret të presidentit nuk mund të kemi Kryeprokuror të Shtetit.

Ndërkaq anëtari tjetër Visar Krasniqi ka thënë se është e pakuptimtë kërkesa që të mos shpallet konkursi, duke shtuar se mungesa e Kryeprokurorit të Shtetit është pengesë dhe se ka qenë kërkesë edhe nga partnerët që të shpallet ky konkurs.

Në fund, me pesë vota për, u votua për shpalljen e konkursit për Kryeprokuror të Shtetit.

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë pune. Pas shpalljes së konkursit për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit, u vendos që Paneli për vlerësimin e kandidatëve për Kryeprokuror të Shtetit të ketë

këtë përbërje: Arian Gashi - kryetar, kurse Visar Krasniqi dhe Elza Bajrami, të jenë anëtarë të Panelit. Ndërkaq, anëtarë rezervë u vendos të jenë Agron Qalaj dhe Arlinda Muqa.

U. d. presidentja Albulena Haxhiu ka përshëndetur shpalljen e konkursit për Kryeprokuror të Shtetit. Ajo ka thënë se ky veprim i Këshillit Prokurorial të Kosovës rikthen mundësinë për një proces të rregullt, transparent dhe të bazuar në meritë. “Është me rëndësi që i gjithë procesi të zhvillohet në mënyrë të paanshme, të besueshme dhe larg çdo ndikimi politik apo interesi të ngushtë, në mënyrë që në krye të Prokurorisë së Shtetit të zgjidhet kandidati më kompetent dhe me integritet të lartë profesional. Besimi i qytetarëve në sistemin e drejtësisë ndërtohet pikërisht përmes proceseve të drejta, transparente dhe të bazuara në meritokraci”, ka thënë Haxhiu.

HAJRIZI: AI NUK DO TA ZËVENDËSOJË PROFESORIN, POR DO TA NDIHMOJË STUDENTIN

PRISHTINË, 18 MAJ - Edmond Hajrizi, rektor dhe themelues i UBT-së, ka folur për rolin e inteligjencës artificiale në arsim dhe mënyrën si teknologjia po ndryshon universitetet dhe tregun e punës. Sipas tij, inteligjenca artificiale po ndryshon me shpejtësi mënyrën si funksionon arsimi dhe universitetet, ndërsa institucionet arsimore po orientohen gjithnjë e më shumë drejt modeleve të reja digjitale dhe të personalizuar të mësim.

Në “Përballje Podcast” në Telegraf, Hajrizi foli për projektet dhe risitë që po zhvillohen në UBT në fushën e inteligjencës artificiale dhe arsimit digjital. Sipas tij, UBT tashmë ka punuar në krijimin e një platforme të integruar me inteligjencë artificiale, ku studentët mund të kenë mbështetje të vazhdueshme përmes sistemeve të bazuara në AI. “Ne kemi punuar shumë në krijimin e gjithë platformës që ka mbështetje nga inteligjenca artificiale, domethënë studenti



me pasë një profesor të bazuar në inteligjencë artificiale”, deklaroi Hajrizi.

Ai tha se ky “profesor virtual” do të jetë në dispozicion të studentëve në çdo kohë, duke

ofruar përgjigje, shpjegime dhe mbështetje të personalizuar sipas nevojave të secilit student. “Është për ty në çdo moment, çdo kohë, njëzet e katër për shtatë. Të jep mbështetje, të jep përgjigje, të shpjegon, të ligjëron, mbi bazën që është e personalizuar për ty”, u shpreh ai. Sipas Hajrizit, ky model i ri i mësimit mund të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e produktivitetit dhe cilësisë së arsimit, duke u mundësuar studentëve qasje më të lehtë dhe më të vazhdueshme në dije

dhe mësim. “Unë mendoj që kjo e rrit produktivitetin dhe e rrit mundësinë që studentët të kenë qasje në mësim dhe mbështetje shumë më të madhe”, tha ai.

Hajrizi theksoi se inteligjenca artificiale nuk duhet parë si zëvendësim i plotë i profesorëve, por si një vegël mbështetëse që ndihmon studentët dhe procesin mësimor në një epokë ku teknologjia po bëhet pjesë e pandashme e arsimit dhe tregut të punës.


Unaza e brendshme e kryeqytetit tashmë në shërbim të qytetarëve

PRISHTINË, 18 MAJ - Të dielën në mbrëmë është përfunduar një prej projekteve më madhore infrastrukturore për kryeqytetin, një investim që për vite me radhë ka qenë

i domosdoshëm për këtë pjesë të qytetit. Komuna e Prishtinës ka njoftuar se ky aks do ta lehtësojë ndjeshëm trafikun, me ndriçim modern, hapësira për

këmbësorë dhe organizim të ri të qarkullimit për një Prishtinë më funksionale, më të lidhur dhe më moderne. “Ky projekt nuk sjell vetëm infrastrukturë të re, por edhe

më shumë siguri, më pak ngarkesë në komunikacion dhe lëvizje më të lehtë për mijëra qytetarë çdo ditë”, ka njoftuar komuna e Prishtinës.



ATK-ja inauguron Qendrën e re për Shërbim të Tatimpaguesve

PRISHTINË, 18 MAJ - Administrata Tatimore e Kosovës ka inauguruar Qendrën e re për Shërbim të Tatimpaguesve e cila operon në një hapësirë të re, më funksionale dhe më të përshtatshme për

tatimpaguesit dhe qytetarët, duke vazhduar me ofrimin e shërbimeve të njëjta. Drejtori i përgjithshëm të ATK-së, Mentor Hyseni, ka deklaruar se tashmë shërbimet ndaj tatimpaguesve të ofrohen në një vend. "Sot po

e përurojmë zyrën e shërbimeve e cila është një prej zyrave më moderne. Ideja është që shërbimet ndaj tatimpaguesve t'i ofrojmë në një vend sa më të afërt, të jenë të qasshme për secilën kategori shoqërore. Në frymën

e kësaj nuk po i rrisim vetëm shërbimet që ka qenë ideja jonë kryesore që më shumë shërbime më pak ndëshkim, por në anën tjetër po rrisim edhe kapacitetin profesional të AKT-së në pjesën operative", ka thënë Hyseni.



SA TË SIGURTA JANË USHQIMET NË TREGUN E KOSOVËS?

PRISHTINË, 18 MAJ - Nga vendi i prodhimit deri në tryezën e konsumatorit, ushqimet duhet të kalojnë një zinxhir të kontrollit të cilësisë, por zakonisht ka një dyshim se sa të sigurt janë produktet që konsumohen nga tregu i Kosovës.

Në podkastin 5 pyetje të Radios Evropa e Lirë, profesori i Teknologjisë Ushqimore, Valdet Gjinovci, thotë se të gjitha produktet të cilat importohen, në bazë të analizës së riskut, i nënshtrohen edhe kontrollit të hollësishëm të tyre sa i përket sigurisë, së pari ana dokumentare, pastaj edhe analizat e ndryshme laboratorike. Ai pohon se duhet informim i menjëhershëm i publikut për çdo gjetje që lidhet me rrezikshmërinë e mundshme të ushqimeve.

Në lidhje me rastet kur për një produkt ushqimor ngrihet alarm dyshimi në shtet e tjera, Gjinovci thotë se edhe institucionet në Kosovë kryejnë kontrolle kur ai produkt shitet

edhe në vend. "Po të kishte produkt të tillë, domethënë nga ai lot i cili është raportuar në një shtet, menjëherë do të merreshin veprime sa i përket kontrollit të tyre dhe largimit të tyre të produkteve nga tregu", tregon ai.

Si ish-kryeshef i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në Kosovë, Gjinovci thekson se publiku duhet të informohet për ta menjatur pasigurinë të konsumatorët.

Kontrolli i pemëve dhe perimeve të importuara

Gjinovci thotë se nga pemët dhe perimet që importohen, merren mostrat në mënyrë rutinore për kontroll, kur ekziston dyshimi për mbetje të pesticideve. Ai thekson se këto kontrolle janë të planifikuara dhe realizohen gjatë gjithë vitit, duke u bazuar në sezon dhe vlerësime të riskut nga autoritetet kompetente.

Një nga elementët më të rëndësishëm për sigurinë



ushqimore, sipas Gjinovcit, mbetet etiketimi i produkteve. "Etiketimi i produktit është si një letërnjoftim i tij, dhe lidhja kryesore me konsumatorin", thotë ai në 5 pyetje të REL-it, duke sqaruar se kjo i mundëson blerësit të kuptojë përbërjen, origjinën dhe afatin e përdorimit të produktit. Sipas tij, leximi i etiketës është hapi i parë që konsumatorët duhet ta bëjnë

për ta mbrojtur veten nga produktet ushqimore të pasigurta.

Sfidat institucionale dhe numri i inspektorëve

Si një nga sfidat kryesore në Kosovë, Gjinovci përmend numrin e kufizuar të inspektorëve që merren me kontrollin në terren. Ai thotë se

zhvillimi i industrisë ushqimore në Kosovë kërkon më shumë kapacitete institucionale për mbikëqyrje dhe këshillim. "Në Shqipëri është numri i madh i inspektorëve, në Maqedoni [të Veriut] gjithashtu, mirëpo në Kosovë çalojnë për sa i përket numrit të inspektorëve, të cilët merren me kontrollin e sigurisë së ushqimit dhe monitorimin e këtij procesi në përgjithësi", shprehet Gjinovci.

Vetëdija e konsumatorëve

Në fund, Gjinovci thekson se vetëdija e qytetarëve për sigurinë ushqimore është në rritje, por ende kërkon kujdes dhe informim të vazhdueshëm. Ai apelon që konsumatorët të jenë të vëmendshëm ndaj etiketave, kushteve të ruajtjes dhe vendit të blerjes së produkteve, sidomos në periudha me temperatura të larta dhe në prag festash, kur rreziku për prishje të ushqimeve është më i madh.

AKB-ja: KOSOVA PO FUNDOSËT EKONOMIKISHT, VENDI I DYTË MË I VARFËR NË EVROPË

PRISHTINË, 18 MAJ - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve, Agim Shahini, e ka konsideruar shqetësim kombëtar dhe dështim institucional faktin që Kosova, sipas raportit të fundit ndërkombëtar për GDP për kokë banori sipas PPP-së, renditet shteti i dytë më i varfër në Evropë, menjëherë pas Moldavisë.

Ai ka thënë se ky raport është pasqyra më e qartë e degradimit ekonomik që po i ndodh Kosovës ndër vite. "Është e papranueshme që një vend me resurset më të mëdha njerëzore në rajon, me diasporë të fuqishme dhe me potencial zhvillimor, të vazhdojë të



mbetet në fund të Evropës për mirëqenie ekonomike. AKB-ja vlerëson se institucionet e Kosovës kanë dështuar të krijojnë politika serioze zhvillimore dhe ambiente të favorshme për biznesin dhe

investitorët. Përderisa vendet e rajonit po ecin përpara me investime, prodhim dhe eksporte, Kosova po vazhdon të mbijetojë nga diaspora, importi dhe konsumi", ka thënë Shahini.

Ai ka theksuar se bizneset në Kosovë po përballen çdo ditë me rritje të vazhdueshme të kostos së energjisë, mungesë të mbështetjes shtetërore, pasiguri ekonomike dhe politike, burokraci të rëndë, ekonomi joformale dhe konkurrencë të padrejtë, si dhe mungesë të strategjisë për prodhim vendor. Është turp ekonomik dhe institucional që Kosova sot renditet pas shumicës së vendeve të rajonit, ndërsa qytetarët po largohen masivisht nga vendi për shkak të mungesës së perspektivës ekonomike", ka deklaruar ai. AKB-ja paralajmëron se pa ndryshime urgjente në politikat

ekonomike dhe pa trajtim serioz të sektorit privat, Kosova rrezikon ta thellojë edhe më shumë varfërinë, papunësinë dhe varësinë ekonomike. "Kërkojmë një paketë emergjente për mbështetjen e prodhimit vendor, ulje të barrës fiskale për bizneset, ndaljen e politikave që rëndojnë sektorin privat, strategji kombëtare për investime dhe eksporte dhe dialog të sinqertë institucional me komunitetin e biznesit. Kosova nuk mund të ndërtojë zhvillim ekonomik me propaganda politike, por vetëm me ekonomi reale, prodhim, investime dhe partneritet me biznesin", ka thënë Shahini.

Nënshkruhet marrëveshje bashkëpunimi mes Inspektoratit të Punës dhe Agjencisë së Punësimit

Prishtinë, 18 maj - Inspektorati Qendror i Punës (IQP) dhe Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) kanë nënshkruar sot marrëveshje bashkëpunimi

me qëllim të forcimit të koordinimit ndër-institucional dhe avancimit të mbikëqyrjes në zbatimin e legjislacionit të punës, veçanërisht lidhur me lejet e punës afatshkurtra për

shtetasit e huaj. Kjo marrëveshje parasheh shkëmbim të rregullt të informatave dhe vendimeve ndërmjet dy institucioneve, me synim rritjen e

transparencës, fuqizimin e mekanizmave të kontrollit dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



SHBA-ja DO QË TA NDRYSHOJË HARTËN ENERGETIKE TË BALLKANIT



Nga Predrag ZVIJERAC, REL

Shtetet e Bashkuara duan ta ndryshojnë mënyrën se si furnizohet me energji Ballkani Perëndimor, duke bërë një rrjet marrëveshesh për importin e gazit të lëngshëm (LNG).

Qëllimi është të ulet varësia e rajonit nga Rusia dhe të forcohet korridori energjetik nga jugu drejt Evropës Qendrore.

Për këtë, janë planifikuar projekte në disa vende të rajonit - nga Kroacia, Bosnje dhe Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Shqipëria dhe Mali i Zi, deri në Kosovë dhe në Serbi.

Këto projekte përfshijnë gazsjellës të rinj, terminale për gazin e lëngshëm dhe termocentrale me gaz, dhe mbështeten politikisht dhe financiarisht nga SHBA-ja dhe Bashkimi Evropian.

Disa nga këto projekte janë tashmë në fazë ndërtimi ose në proces kontraktimi, ndërsa të tjerat janë ende në fazën e planifikimit.

Në përgjithësi, sistemi energjetik rajonal është duke u orientuar gradualisht drejt gazit natyror nga SHBA-ja, Azerbajxhani dhe Mesdheu.

Jonathan Stern, profesor në Institutin Oxford për Studime Energjetike, vlerëson se Evropa Juglindore tashmë ka zhvilluar rrugë alternative të furnizimit.

“Ekzistojnë terminale të LNG-

së në Greqi dhe Kroaci, dhe Korridori Jugor i Gazit nga Azerbajxhani, së bashku me fushën rumune të gazit Neptun Deep në Detin e Zi, shfrytëzimi i së cilës pritet të fillojë vitin e ardhshëm dhe rezervat e së cilës vlerësohen në 100 miliardë metra kub”, thotë Stern për Radion Evropa e Lirë.

Bosnje dhe Hercegovina ishte në qendër të vëmendjes në muajt e fundit, për shkak të projektit të Ndërlidhjes Jugore të Gazit me Kroacinë, i cili do t'i siguronte entitetit të Federatës së Bosnjës qasje në terminalin e LNG-së në Kërk dhe furnizues alternativ të gazit.

Në të njëjtën kohë, autoritetet e entitetit tjetër të Bosnjës, Republika Sërpska, vazhdojnë të zhvillojnë lidhje të ndara gazi me Serbinë, duke përfshirë projektin e Ndërlidhjes Lindore nga Bijelina në Banja Llukë.

Për gati pesë dekada, Bosnje dhe Hercegovina ka qenë plotësisht e varur nga gazi rus, i cili i shkoi nëpërmjet Rrjedhës Turke.

Ai përdoret kryesisht për ngrohje në Sarajevë dhe, krahasuar me Serbinë, Bosnja është një konsumatore e papërfillshme.

Marrëveshja midis Bosnje dhe Hercegovinës dhe Kroacisë për lidhjen e gazsjellësit nga Dalmacia në Bosnjën qendrore, me degë në Hercegovinë dhe veriperëndim të vendit, u nënshkrua me pjesëmarrjen e

sekretarit të Energjisë të SHBA-së, Chris Wright, në mujain prill në Dubrovnik.

Asaj i paraprinë disa muaj mbështetje zyrtare nga Uashingtoni për projektin, i cili u përshkrua si “strategjik për sigurinë energjetike të rajonit”.

Pjesa kroate e projektit drejtohet nga kompania shtetërore Plinacro, ndërsa në Bosnje dhe Hercegovinë nga kompania private amerikane AAFS Infrastructure and Energy, drejtorët e së cilës janë pjesë e rrethit të ngushtë të presidentit të SHBA-së, Donald Trump.

Projekti shkaktoi kritika nga Komisioni Evropian dhe Komuniteti i Energjisë, anëtare e të cilit është Bosnje dhe Hercegovina, për shkak të një ligji të posaçëm (lex specialis) në Federatën e Bosnjës që përfshin një kompani private amerikane, si dhe çështjeve të pajtueshmërisë me rregullat e BE-së.

“Projekti duhet të zbatohet brenda një kuadri që është plotësisht në përputhje me acquis-in ligjor të Komunitetit të Energjisë dhe me parimet e politikës energjetike të BE-së”, tha për Radion Evropa e Lirë Hanna Claeson, zëdhënëse e Komunitetit Evropian të Energjisë, anëtare e të cilit janë vendet e BE-së, Bosnje dhe Hercegovina dhe vendet e tjera të rajonit.

Bosnje dhe Hercegovina konsumon deri në 250 milionë metra kub gaz në vit, ndërsa përmes gazsjellësit të ri

parashikohet të transportohen rreth 1.5 miliard metra kub. Për këtë arsye është duke u shqyrtuar edhe ndërtimi i termocentraleve me gaz, të cilat do të mund të furnizonin me energji elektrike rreth 400.000 familje.

Aktualisht, 80 për qind e energjisë elektrike prodhohet në termocentrale me qymyr, disa prej të cilave janë ndërtuar më shumë se 50 vjet më parë.

Tubacioni i planifikuar do të lidhet me atë ekzistues që vjen nga Serbia.

Stern, nga Instituti i Oksfordit për Studime të Energjisë, beson se tubacioni “është i rëndësishëm për Bosnje dhe Hercegovinën, por jo për rajonin më të gjerë”.

Ai, gjithashtu, shpreh dyshime për levërdinë e investimit prej rreth 1 miliard eurosh - sa vlerësohet ndërtimi i këtij gazsjellësi të ri.

“Kroacia nuk ka kapacitet të disponueshëm të LNG-së për transitin e gazit përmes Bosnje dhe Hercegovinës. Dhe, ku do të shkonte? Serbia tani mund ta marrë atë përmes Bullgarisë”, thotë Stern.

Serbia po zgjeron infrastrukturën e saj të gazit në përpjekje për të ruajtur rolin e saj si qendër rajonale e energjisë, duke hapur njëkohësisht hapësirë për LNG-në amerikane dhe investime të reja perëndimore në sektorin e energjisë.

Ministrja serbe e Energjisë, Dubravka Gjedoviq Handanoviq, nënshkroi një

deklaratë të përbashkët me SHBA-në dhe disa vende të Evropës Lindore dhe Qendrore në një samit në Uashington në shkurt të këtij viti.

Shefi i ndërmarrjes Srbijagas, Dushan Bajatoviq, deklaroi më pas se Serbia “do të duhet të blejë gaz amerikan”, megjithëse sasi të dhe kontratat formale nuk janë përcaktuar ende.

Marrëveshja Strategjike e Energjisë e vitit 2024 me SHBA-në parashikon diversifikimin e burimeve, por ende nuk ka një kontratë formale për blerjen e LNG-së amerikane.

Gazi amerikan mund të mbërrijë nëpërmjet terminalit kroat në Kërk ose Aleksandropolisit grek, falë ndërlidhjeve të reja me Bullgarinë dhe Maqedoninë e Veriut.

Serbia operon një rrjet prej rreth 2.500 kilometrash tubacionesh gazi dhe planifikon tubacione të reja, duke përfshirë edhe Maqedoninë e Veriut, dhe po zgjeron objektin e magazinimit të Banatski Dvorit.

Aktualisht, më shumë se 80 për qind të gazit, Serbia e merr nga Rusia përmes Rrjedhës Turke. Pavarësisht njoftimeve për diversifikim, objektet kryesore të gazit në Serbi, përfshirë termocentralin-kogjenerues TE-TO Pančevo, vazhdojnë të jenë të lidhura me Gazprom-in rus dhe me Industrinë e Naftës së Serbisë.

Mali i Zi - megjithëse pa rrjet

gazi - është duke u bërë pjesë e kuadrit amerikan të LNG-së, përmes planeve për një terminal në portin e Tivarit dhe termocentraleve të ardhshme me gaz.

Mali i Zi, gjithashtu, mori pjesë në Samitin Amerikan Transatlantik të Sigurisë së Gazit në Uashington, në shkurt të këtij viti, ku nënshkroi një deklaratë të përbashkët, me të cilën disa vende të Evropës Qendrore dhe Jugore njoftuan se do të bashkëpunojnë me SHBA-në në energji.

Edhe pse kompanitë amerikane Enerflex dhe Wethington Energy Innovation nënshkruan një memorandum me Qeverinë e Malit të Zi në vitin 2023 për përgatitjen e projektit, ende nuk ka marrëveshje për furnizimin me LNG, nuk janë caktuar sasisht dhe nuk janë nënshkruar kontrata konkrete. Mali i Zi, ndërkohë, ka mbështetur projektin e gazsjellësit Jon-Adriatik (IAP), i cili do ta lidhte gazsjellësin Transadriatik (TAP) në Shqipëri me Kroacinë, por ai ende mbetet në fazën e planit fillestar.

Përndryshe, disa termocentrale me gaz me kapacitete që variojnë nga 50 deri në 400 megavate, po merren në konsideratë në Tivar, Podgoricë dhe Plevle, duke përfshirë modele hibride dhe konvertime të termocentraleve ekzistuese. Sipas studimeve të realizuara për Elektroekonominë e Malit të Zi nga kompania japoneze

JERA dhe konsulencia zvicerane SS&A Power Consultancy, të gjitha opsionet e shqyrtuara janë teknikisht të realizueshme dhe ekonomikisht të leverdishme.

Në varësi të kapacitetit të termocentralit dhe burimit të furnizimit me gaz, investimet vlerësohen të variojnë nga 233 deri në 362 milionë euro.

Kosova nuk ka infrastrukturë të gazit dhe mbështetet plotësisht në termocentralet me qymyr.

Projekti për një interkonektor gazi me Maqedoninë e Veriut është përfshirë më herët në planin investues të BE-së për Ballkanin Perëndimor, por është ndalur për shkak të, siç kanë thënë nga Qeveria, kostove të larta dhe fokusit strategjik në burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Tubacioni do t'i jepte Kosovës qasje në gaz nga терминаlet greke të LNG-së në Detin Egje, dhe ideja ishte të ndërtohej edhe një tubacion drejt Shqipërisë.

“Nëse dhe kur kushtet e tregut ndryshojnë dhe mjedisi i biznesit bëhet më tërheqës, Departamenti i Energjisë [i SHBA-së] do të jetë i gatshëm të ndihmojë në lidhjen e kompanive amerikane me partnerët në Kosovë”, ka thënë për Radion Evropa e Lirë Joshua Volz, i dërguar i posaçëm i Departamentit amerikan të Energjisë.

Kosova ka refuzuar të investojë rreth 200 milionë dollarë amerikanë në infrastrukturën e gazit përmes programit të

Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) dhe i ka devijuar fondet në sistemet e ruajtjes së energjisë në bateri. Shkupi, aktualisht, është duke ndërtuar infrastrukturë të re të gazit me mbështetjen e Uashingtonit dhe Brukselit, me synimin që të shkëputet nga varësia shumëvjeçare nga gazi rus dhe të pozicionohet si një qendër e re energjetike rajonale.

Maqedonia e Veriut është anëtare e NATO-s dhe kandidate për BE, prandaj diversifikimi i furnizimit me energji është bërë edhe çështje gjeopolitike.

Termocentrali-kogjenerues TE-TO Shkup, që furnizon kryeqytetin me ngrohje dhe prodhon energji elektrike, varet nga gazi rus dhe është nën kontrollin e grupit rus Sintez.

Shkupi ka nënshkruar një memorandum me furnizues amerikanë për blerjen e LNG-së, por detajet nuk janë bërë publike.

Gazsjellësi Gjevgjeli-Negotinë është në ndërtim e sipër dhe do ta lidhë këtë vend me терминаlet LNG në Greqi, me një kapacitet fillestar prej 1.5 miliard metrash kub në vit.

Institucionet e BE-së janë duke e financuar projektin me një kombinim kredish dhe grantesh, ndërsa, paralelisht, po planifikohet edhe një ndërlidhje me Serbinë - me punimet që pritet të fillojnë në vitin 2027.

“Maqedonia e Veriut planifikon të ndërtojë 67

objekte të reja energjetike, me një kapacitet të instaluar total prej 4.416 megavatesh, duke përfshirë një central bashkëprodhimi pranë Negotinit”, tha Ministria e Energjisë, Minerave dhe Burimeve Minerale e Maqedonisë së Veriut për Radion Evropa e Lirë.

Në prill të këtij viti, Shqipëria nënshkroi një marrëveshje strategjike, me vlerë 6 miliardë dollarë, me kompaninë amerikane Venture Global dhe kompaninë greke Aktor LNG USA, të cilat do të blejnë LNG nga Shtetet e Bashkuara për furnizim afatgjatë - nisur nga viti 2030.

Plani përfshin zhvillimin e një qendre energjetike në Vlorë, me një terminal LNG dhe një termocentral me gaz me kapacitet prej rreth 380 megavatesh, me lidhje me Gazsjellësin Trans-Adriatik (TAP), i cili transporton gaz nga Azerbajxhani në Itali që nga viti 2020.

Projekti mbështetet nga administrata amerikane, e cila e sheh Shqipërinë si një pikë hyrjeje të mundshme për shpërndarjen e gazit amerikan në Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe pjesë të tjera të Ballkanit Perëndimor.

Shqipëria nuk ka një rrjet të brendshëm funksional të gazit dhe infrastruktura ekzistuese nga periudha socialiste është kryesisht e papërdorshme.

Për Shqipërinë, e cila pothuajse të gjithë energjinë elektrike e prodhon nga hidrocentralet, ndërtimi i një

termocentrali me gaz do të shërbente si rezervë sigurie në periudhat e thatësirës dhe rritjes së konsumit.

“Zgjidhja për gazifikimin e Shqipërisë është ndërtimi i Gazsjellësit Jon-Adriatik (IAP) dhe lidhja me terminalin e LNG-së në Kroaci, lidhja me Gazsjellësin Trans-Adriatik (TAP), përmes të cilit vjen gazi nga rajoni i Kaspikut, dhe ndërtimi i një terminali të LNG-së dhe magazinimit të gazit në Dumrei”, thotë Stavri Dhima, nga Universiteti Evropian në Tiranë, i cili ka punuar për 20 vjet në Institutin për Kërkime të Naftës dhe Gazit në Fier.

Terminali i LNG-së në portin e Vlorës mund të jetë një qendër gazi për furnizimin e Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, dhe nëpërmjet IAP-it dhe TAP-it gazi mund të shkojë edhe në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Itali.

“Vetëm infrastruktura nuk garanton siguri energjetike”, thotë për Radion Evropa e Lirë Sophie Corbeau, nga Qendra për Politika Globale të Energjisë në Paris, duke iu referuar planeve për ndërtimin e terminaleve të reja të LNG-së, tubacioneve të gazit dhe termocentraleve me gaz.

Vendet që duan ta zvogëlojnë varësinë e tyre nga gazi rus, duhet së pari të sigurojnë kontrata të besueshme afatgjate me disa furnizues, përfundon Corbeau.





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

AFRIM OSMANAJ ZGJEDHET KRYETAR I FEDERATËS SË FUTBOLLIT SHQIPTAR NË GJERMANI, SHQIPTAR GUBETINI NËNKRYETAR

STUTTGART, 18 MAJ - Në Ludwigsburg të Stuttgartit është mbajtur Kuvendi Zgjedhor i Federatës së Futbollit Shqiptar në Gjermani (FFShGj). Në këtë proces zgjedhor kanë marrë pjesë 93 delegatë nga klubet shqiptare në Gjermani të cilët kanë votuar për zgjedhjen e kryetarit të ri të FFSHGj-së. Pas votimit, me shumicë votash, kryetar është zgjedhur Afrim Osmanaj, ndërsa nënkryetar është zgjedhur Shqiptar Gubetini. Në garë për kreun e ri të FFSHGj-së ishin tre kandidatë: Afrim Osmanaj, Arben Kelmendi



dhe Bujar Neziri. Gjatë punimeve të Kuvendit të FFSHGj-së ishin të



pranishëm edhe presidenti i FFK-së, Agim Ademi, anëtari i KE-së së

FFK-së nga diaspora, Enver Muzliukaj, si dhe kryetari i



Unionit të Klubeve Shqiptare të Futbollit në Zvicër, Feti Demolli.

MALISHEVA SIGURON EVROPËN, FERIZAJ DHE PRISHTINA E RE BIEN NGA SUPERLIGA

PRISHTINË, 18 MAJ - Java e 34-t e Albi Mall Superligës së Kosovës ka sjellë zhvillime të rëndësishme në garën për Evropë dhe në luftën për mbijetesë. Malisheva ka siguruar matematikisht pjesëmarrjen në garat evropiane, ndërsa Prishtina e Re dhe Ferizaj përfundimisht kanë humbur shpresat për mbetje në elitë dhe edicionin e ardhshëm do të garojnë në Ligën e Parë. Malisheva ka siguruar matematikisht pjesëmarrjen në kualifikimet e Ligës së Konferencës pas fitores bindëse 4:1 ndaj Drenicës në stadiumin "Liman Gegaj". Pas pjesës së parë pa gola, Assane Diatta ka realizuar dy herë (55', 81'), ndërsa Arlind Veliu dhe Xhemal Ibishi kanë shtuar nga një gol tjetër. Kreshnik Uka ka shënuar

golin e vetëm për mysafirët në kohën shtesë. Malisheva tashmë ka siguruar pozitën e tretë në tabelë dhe do ta përfaqësojë Kosovën në garat evropiane së bashku me Dritën dhe Ballkanin. Në stadiumin "18 Qershori" në Klinë, Dukagjini ka shënuar fitore ndaj kampionës së këtij edicioni, Dritës, me rezultat 2:0. Skuadra klinase ka kaluar në epërsi me golin e Besir Isenit në minutën e 19, ndërsa Altin Merlaku ka realizuar golin e dytë në minutën e 41-të. Dukagjini i është anuluar edhe një gol për pozitë jashtë loje në pjesën e parë. Me këtë fitore Dukagjini mbetet në pozitën e pestë me 45 pikë, aq sa ka edhe Gjilani në vendin e gjashtë. Në Suharekë, Ballkani ka fituar ndaj Prishtinës së Re me rezultat 3:2, duke vulosur rënien e



skuadrës kryeqytetase nga Superliga. Mysafirët kanë kaluar dy herë në epërsi me golat e Nedim Mekiqit, por Ballkani reagoi përmes Giovanni Ribeiros, Anel Shabanxhoviqit dhe Almir Kryeziut, i cili ka realizuar golin e fitores në minutën e 87. Një ndeshje dramatike është

zhvilluar në Kampin Nacional në Hajvali, ku Prishtina dhe Ferizaj kanë barazuar 3:3. Ky rezultat ka bërë që Ferizaj përfundimisht t'i humbë shpresat për mbetje në elitë. Prishtina ka kaluar e para në epërsi me Albin Krasniqin, ndërsa Ferizaj ka reaguar përmes Ruben Silva-Richards nga penalltia. Sulmuesi i talentuar Rin Ahmeti ka realizuar dy gola për prishtinasit, përfshirë edhe atë të barazimit në minutat shtesë, duke ia mohuar Ferizajt fitoren. Për vendasit realizuan edhe Betim Haxhimusa dhe Ade Oguns. Fitore shumë të rëndësishme në luftën për mbijetesë ka arritur Llapi, që ka triumfuar në udhëtim ndaj Gjilanit me rezultat 2:1. Arianit Hasani ka realizuar dy gola për llapjanët, në minutën 8 dhe 27, ndërsa për

vendasit ka shënuar Armend Thaqi me një supergol nga goditja e dënimit në minutën e 15. Llapi mbetet në pozitën e tetë me 43 pikë, ndërsa Gjilani bie në vendin e gjashtë me 45 pikë dhe tani rrezikon të mbetet në barazh.

RENDITJA TABELARE NË SUPERLIGË

Drita	66
Ballkani	58
Malisheva	56
Prishtina	46
Dukagjini	45
Gjilani	45
Drenica	44
Llapi	43
Ferizaj	36
Prishtina e Re	31

MALLORCA E MURIQIT RREZIKON SERIOZISHT RËNIEN NGA LA LIGA



MALLORCA, 18 MAJ - Mallorca e Vedat Muriqit ka marrë një tjetër goditje të rëndë në La Liga, duke u mposhtur 2-0 nga Levante. Kjo disfatë ia ka ulur edhe më shumë gjasat e skuadrës për të mbetur në elitën spanjolle, me vetëm një xhiro të mbetur deri në fund të kampionatit. Vendasit kanë

kaluar në avantazh në minutën e 32-të, kur Carlos Espi ka përfutur nga një gabim i mbrojtjes së Mallorcës dhe ka realizuar me qetësi nga afër zonës për 1-0. Mallorca ka tentuar të reagojë, por nuk ka arritur të krijojë rrezik serioz, ndërsa në pjesën e dytë loja është komplikuar edhe më shumë me

ndërprerje dhe tensione. Momenti që ka vulosur ndeshjen ka ardhur në minutën e 87, kur Kervin Arriaga është shkëputur më lart pas një goditjeje këndi dhe ka shënuar me kokë për 2-0. Sulmuesi i Kosovës dhe Mallorcës, Vedat Muriqi, ka luajtur 90 minuta, por pa arritur të shënojë. Me këtë humbje,

Mallorca mbetet në një pozicion shumë të vështirë dhe me shanse minimale për mbijetesë në La Liga, duke pritur tani llogaritjet dhe rezultatet e xhros së fundit për të mësuar fatin e saj. Në rast se nuk vjen mrekullia, sezoni i ardhshëm mund ta gjejë skuadrën e Muriqit në Segunda Division.

Barcelona zyrtarizon vazhdimin e kontratës me Flickun

Barcelonë, 18 maj - Gjermani Hansi Flick do të vazhdojë ta drejtojë skuadrën e Barcelonës. Kampionia e Spanjës ka njoftuar se Flicku ka

vazhduar kontratën me Barcelonën dhe do të jetë në krye deri në vitin 2028. Flicku në krye të Barçës është nga vera e vitit 2024. Këtë skuadër ai e ka

udhëhequr drejt dy titujve të Spanjës, Kupës së Mbretit në vitin 2025 dhe dy Superkupave spanjolle. 61-vjeçari vlerësohet shumë në Spanjë. Synim e ka që Barçën

ta kthejë në krye të futbollit evropian, përkatësisht që ta fitojë Championsin. Flicku ka drejtuar edhe Bayernin e Hoffenheimin, kurse ishte edhe selektor i Gjermanisë.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 38 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës (ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (ZKA) Nr. 03/2025), Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2025 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.758 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit rishpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Zyrtar për Komunikim me Publikun
Numri i referencës:	RZKP/ZKA/12-15/25
Grada:	ZKA-X6
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofron përkrahje profesionale në fushën e komunikimit dhe bashkëpunimit me palët e interesit;
- Ndihmon në përgatitjen e propozimeve dhe hartimin e planeve të komunikimit me palët e interesit;
- Ndihmon në përgatitjet e konferencave për media, njoftime për shtyp, deklarata dhe raporte për media;
- Ndihmon në përgatitjen dhe koordinimin e takimeve dhe forumeve me shoqërinë civile për marrjen e inputeve të jashtme lidhur me auditimin;
- Përditëson faqen elektronike zyrtare të ZKA-së;
- Përgatit njoftimet dhe informacionin e nevojshëm për nevoja të lajmeve dhe komunikimit me publikun për pjesëmarrjen e ZKA-së në aktivitetet e organizuara nga palët e interesit dhe aktivitetet ndërkombëtare;
- Monitoron dhe përcjell mediat lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me ZKA-në;
- Koordinon kërkesat nga palët e interesit dhe përgatitë raporte për angazhimin e ZKA-së në këto aktivitete;
- Bashkëpunon me të gjitha njësitë tjera organizative të ZKA-së për çështje reprezentative që kanë të bëjnë me promovimin e punës së ZKA-së.
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga Drejtori i departamentit

Kërkesat e përgjithshme formale për këtë pozitë të punës, janë:

- Arsimimi: Diplomë fakulteti në shkencat shoqërore, gazetari ose komunikim masiv.
- Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në gazetari apo komunikim.
- Preferohet njohuri të gjuhës angleze.

Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit publik;
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve sipas afateve;
- Shkathtësi kompjuterike dhe të përdorimit të aplikacioneve dhe programeve si dhe platformave dixhitale për komunikim (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit, wordpress, uebfaqe, rrjete sociale etj.).

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **03.06.2026 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa članom 15.2 Zakona br. 05/L-055 o generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i članovima 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 01/2024 o prijemu i karijeri u Nacionalnoj kancelariji revizije, u vezi sa članom 38 Pravilnika (NKR) 03/2024 o klasifikaciji radnih mesta (izmenjeno i dopunjeno Pravilnikom (NKR) br. 03/2025), Godišnjim planom zapošljavanja za 2025. godinu i Odlukom generalne revizorke br. 758 o popunjavanju slobodnog radnog mesta, Nacionalna kancelarija revizije ponovo objavljuje:

KONKURS za popunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Pozicija:	Službenik za komunikacije sa javnošću
Referentni broj:	RZKP/ZKA/12-15/25
Rang:	ZKA-X6
Broj pozicija:	Jedna (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Pruža stručnu podršku u oblasti komunikacije i saradnje sa zainteresovanim stranama;
- Pomaže u pripremi predloga i izradi planova komunikacije sa zainteresovanim stranama;
- Pomaže u pripremanju konferencije za medije, saopštenja za štampu, izjave i medijski izveštaji;
- Pomaže u pripremi i koordinaciji sastanaka i foruma sa civilnim društvom kako bi se dobili doprinosi spolja u vezi sa revizijom;
- Ažurira zvaničnu veb stranicu NKR-a;
- Priprema saopštenja i informacije neophodne za potrebe vesti i komunikacije sa javnošću u vezi sa učešćem NKR-a u aktivnostima koje organizuju zainteresovane strane i međunarodnim aktivnostima;
- Prati i nadgleda medije u vezi sa pitanjima vezanim za NKR;
- Koordinira zahteve zainteresovanih strana i priprema izveštaje o angažovanju NKR-a u ovim aktivnostima;
- Saraduje sa svim ostalim organizacionim jedinicama NKR-a o reprezentativnim pitanjima koja se odnose na promovisanje rada NKR-a.
- Obavlja i druge poslove koje mu dodeli direktor odeljenja

Opšte formalne kvalifikacije za ovu poziciju su:

- Obrazovanje: Fakultetska diploma društvenih nauka, novinarstva ili masovne komunikacije
- Profesionalno iskustvo: Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u novinarstvu ili komunikaciji
- Poželjno je znanje engleskog jezika.

Potrebne veštine:

- Znanje i iskustvo u oblasti novinarstva i javne komunikacije;
- Veštine komunikacije i planiranja posla;
- Istraživačke, analitičke, ocenjujuće veštine i formulisanje preporuka i stručnih saveta;
- Sposobnost ispunjavanja zadataka i posla prema rokovima;
- Poznavanje rada na računaru i korišćenje aplikacija i programa, kao i digitalnih platformi za komunikaciju (Word, Excel, Power Point, Access, internet, WordPress, veb stranice, društvene mreže itd.).

Opšte informacije za kandidate:

Određivanje plate se vrši u skladu sa važećim zakonskim propisima.

Postupak prijave:

Postupak prijavljivanja je otvoren za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna kancelarija revizije nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja kandidate iz svih zajednica na Kosovu.

Kandidati moraju da dostave potrebnu dokumentaciju, kao nadole:

- službeni obrazac za prijavu NKR-a;
- kopija lične karte Republike Kosovo;
- dokaz o obrazovnoj spremi (diploma fakulteta). Diplome stečene van Kosova moraju biti nostrifikovane;
- dokaz o radnom iskustvu (Ugovor o radu ili Potvrda o radnom odnosu, uz dokaz iz Trusta);
- dokaz iz suda da nije pravosnažno osuđivan (ne stariji od šest meseci);
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa položaja javnog službenika (ako je primenljivo);

Samo službeni obrazac za prijavu će biti uzet u obzir. Dokumenti podneti nakon roka neće biti razmatrani, a nepotpuni će biti odbijeni. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume. Konkurs je otvoren 15 dana od dana objavljivanja u elektronskim medijima (*onlajn*) i na veb stranici Nacionalne kancelarije revizije. Rok za podnošenje dokumentacije je **03.06.2026 u 16:00 časova**.

Obrasci za prijavu mogu se dobiti na recepciji NKR-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na www.zka-rks.org i dostaviti Odeljenju za upravljanje dokumentima na adresu: Naselje: Arberia, ul. „Ahmet Krasniqi“ br. 210 – Prishtina, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00 časova, obrazac i prateća dokumentacija mogu se dostaviti i putem e-pošte na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete kontaktirati tel. br. 038/606-004, lok. 1025.

Napomena:

Prijave poslate poštom, koje nose poštanski žig o pošiljci dostavljeno poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se važećim i biće uzete u razmatranje.

OBAVEŠTAVAM

Moje suvlasnike: ÇAMIL (Jashar) JASHARI, LJATA (Nijazija) TAIRI, BAJRAM (Hasan) TELAKU, SAFET (Ashim) SADIKI, SEJBIT (Ashim) SADIKI, HANIFA SADIKI, (Ashim) SADIKI, SAIT (Ashim) SADIKI, SABIT (Ashim) SADIKI, MUSTA (Ilijaz) NEXHMEDIN (Hasip) NEZIRI, AJRIJA MURTOVI rod.SADIKI, AZEMKA (Beqir) META, PETRIT (Xhavit) DINA, BESNIK (Xhavit) DINA, AZEMKA (Beqir) BILIBANI, HASAN (Amdi) RAKAJ i MESTAN (Harun) MESTANI kao zainteresovani kupci, JA: FARIJE (Bećir) AMETI kao suvlasnik sa idelanim delom 6/48, prodajem u celosti moj suvlasnički deo susvojine, što obuhvata površinu od 703.125m², na Kat-Parceli: P-71813068-05462-0 Katastarska Zona Prizren.

Ovim putem nudim suvlasnicima ukoliko su zainteresovani za kupovinu moje suvlasničkog dela, da se javu u roku od 30 dana. Ujedno obaveštavam da već imam potencijalnog Kupca koji će u roku od 30 dana platiti kupoprodajnu cenu od 70.000,00€ za površinu od 703.125m² od parcele P-71813068-05462-0, i to načinom uplate u gotovini /odjednom preko banke.

Kontakt telefon: 049-739-947.



Prishtinë, 07.05.2026

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria „L&D ENERGY SOLUTION“ SH.P.K., me numër Unik Identifikues 812109454 me adresë: Rr. „Mazllam Kastrati, Tranziti i Vjetër“ pn, Komuna e Prizrenit, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 14.04.2026 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit dhe për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej 1 MW ZK Petrovë, Komuna e Prizrenit, Republika e Kosovës.

Shoqëria „L&D ENERGY SOLUTION“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 1 MW ZK Petrovë, Komuna e Prizrenit, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Mjedisor Nr.4363-2/25 dt. 18.08.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Njoftimin Nr. 04-353/01-21408 të dt. 07.03.2025 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.
- Aktvendimin nr. 04-353/01-135622 të dt. 10.10.2025 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Prizrenit.
- Vendimin për Leje Ndërtimore Nr.04-353/01-22408 dt. 19.03.2026, për “Vendosjen e paneleve solare fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 1 MW, ngastrata katastrale 00142-1 ZK Petrovë, gjegjësisht në objektin me nr. 24-0 ZK Petrovë, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Prizrenit.
- Pëlqimin Elektroenergetik Nr. 4131 dt. 24.03.2026 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratrat për shfrytëzimin e tokës);
- Deklaratën për shitjen e energjisë;
- Dëshmi për posedimin e 10% të vlerës së investimit;
- Parakontratën për Inxhinieri, Prokurim dhe ndërtim (EPC);
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar,
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar deklaratën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund ti paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: luan@ild-prizren.com, erzen.krasniqi@solar2.eu dhe LEGAL-LECENSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Ergresa Dula shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë, dega Junik.

- Luan Matoshi shpall të pavlefshme dëftesat e kl.1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit “Hjadar Dushi” Gjakovë.

- Arbenita Isufi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Sabit Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Institucionit të Arsimit dhe Aftësimin Profesional “Fehmi Agani” Klinë.

- Vilson Gjykej nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Engjëll Gjoni”, Novosellë, nga klasa 1-8.

- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Baçelor i Edukimit Fillor.

- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.

- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.

- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Buna Sada shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Albrim Sylja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Andi Firzi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 marsi” Prizren.

- Francez Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Zef Lush Marku” Velezhe.

- Kristijan Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IXshfmu “ Zef Lush Marku” Velezhe.

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

